# V E N D I M

Nr. 3 date 8.07.2005

I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE TREGETARE " HODAJ " SHPK

Une Ilir Hodaj ortak i vetem dhe administrator i shoqerise tregetare " HODAJ " SHPK ne mbledhjen time te dates 8.07.2005 kam vendosur:

Miratimin e raportit te vleresimit per zmadhimin e kapitalit te shoqerise " HODAJ " SHPK ne masen 33.312.177 leke, i cili ky kapital mbas zmadhimit behet ne madrn 33.512.177 leke.

Depozitimin e ketij vendimi prane rregjistrit tregetar.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE
TREGETARE " HODAJ " SHPK
ILIR HODAJ

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA E TIRANES
Nr. 5410 Rep

Tirane ,me 8.07.2005

VERTETIM

Vertetohet se vendimi i ortakut te vetem te shoqerise tregetare "S HODAJ " SHPK u nenshkrua ne prezencen time nga ortaku i vetem Ilir Hodaj per indetitetin e te cilit u sigurova nga dokumenti indetifikues dhe une notere e vertetoj sipas ligjit.

PULLE TAKSE
LEKE
U LIKUJDUA

NOTERE
SILVANA MERKO

*Fatbardha Shtrepi, Eksperte Kontabel Autorizuar*

# RAPORT VLERESIMI

## Per zmadhimin e kapitalit te Shoqerise "HODAJ"Sh.p.k.VLORE. Nepermjet fitimeve te mbartura e fitimeve te vitit 2004.

Zoteri !

Une Fatbardha SHTREPI Auditore e Licensuar ne Licensen Nr 130 me Vendimin e Asamblese se Ortakeve nr 1 dt 29 Qershor 2005 si dhe me vendimin e Gjykates se Shkalles se pare ***Nr 17 909/2 Dt 07 Korrik 2005*** jam ngarkuar per kryerjen e e misionit te Zmadhimit te Kapitalit te Shoqerise suaj "HODAJ"Sh.p.k.
Mbeshtetur ne ligjin ne 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare",nenet 40,62 e 150 kam kryer misionin tim per vleresimin e kontributeve qe kane ndikuar ne zmadhimin e kapitalit te shoqerise "HODAJ"Sh.p.k. Vlore.

Per Kryerjen e misionit tim kam shfrytezuar:

1. Bilancin Financiar se bashku me anekset e tij, te "HODAJ"Sh.p.k. Vlore te vitit 2004.
2. Dokumentacionin kontabel te regjistrimeve te Shoqerise"HODAJ"Sh.p.k. Vlore.
3. Statutin e Shoqerise "HODAJ"Sh.p.k. Vlore.

Shoqeria "HODAJ"Sh.p.k. Vlore eshte krijuar me vendimin e Gjykates se Shkalles se pare Tirane ***Nr 17 909 Date 14 10 1997,*** me kapital te Nenshkruar prej 200 000 leke .Zoterues te ketij Kapitali ne momentin e krijimit te Shoqerise eshte Z.Ilir HODAJ mbajtes i 100% aksioneve.
Qe nga krijimi i Shoqerise "HODAJ"Sh.p.k. Vlore deri sot nuk kemi ndryshime te kapitalit te nenshkruar .Administratori i Shoqerise eshte Z. Ilir HODAJ.

Sipas vendimit te Asamblese se Ortakut te Vetem eshte vendosur zmadhimi i kapitalit te shoqerise nga Fitimi i krijuar deri me mbylljen e vitit ushtrimir 2004.
Nga shqyrtimi i Dokumentacionit rezultoi si me poshte:
Shoqeria ne bilancin Financiar te vitit 2004 ka te pasqyruar ne postin Fitime e humbje te mbartura shumen prej 15 685 090 leke si dhe ne postin Fitime e humbje te ushtrimit shumen 17 627 087 leke.
Sipas pasqyres se meposhtme:



Ekspert Kontabël e Autorizuar
FATBARDHA SHTREPI
TIRANË - ALBANIA

| Fitime dhe Humbje | 31 Dhjetor 2004 | 31 Dhjetor 2003 |
|---|---|---|
| Fitime/Humbje te mbartura | 15,685,090.00 | 8,628,780.00 |
| Fitime dhe Humbje te ushtrimit | 17,627,087.00 | 7,056,310.00 |
| **Totali** | **33,312,177.00** | **15,685,090.00** |

Ne baze te te dhenave te mesiperme e te legjislacionit ne fuqi Asamblea e Ortakut te Vetem te Shoqerise "HODAJ"Sh.p.k. Vlore me vendimin e tij Nr 1 Dt 29 Qershor 2005 ka vendosur Zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise "HODAJ"Sh.p.k.me te gjithe vleren e fitimeve te realizuara deri me 31 Dhjetor 2004 ne masen ***33 312 177 leke***.Sipas llogaritjeve te bera pas rritjes se kapitalit vlera e kapitalit te nenshkruar behet ***33 512 177 leke*** dhe eshte ne pronesi te personit private Z. Ilir HODAJ mbajtes 100 % te aksioneve te shoqerise.

Keshtu posti i kapitaleve ne bilancin e celjes se shoqerise per vitin 2005 do te na paraqitej sipas tabeles se meposhtme:

| Permbajtja | Viti 2005 | Viti 2004 | Ritja e bere |
|---|---|---|---|
| ***Kapitali Themeltar*** | ***70,234,295*** | ***70,234,295*** | ***33,312,177*** |
| Kapitali I Nenshkuar | 33,512,177 | 200,000 | 33,312,177 |
| Rezerva | 36,722,118 | 36,722,118 | - |
| Fitime te viteve te kaluara | - | 15,685,090 | (15,685,090) |
| Fitim I vitit ne vazhdim | - | 17,627,087 | (17,627,087) |

Si perfundim theksoj se zmadhimit te kapitalit I pergjigjen fitimet e realizuara nga Shoqeria "HODAJ"Sh.p.k. Vlore qe nga krijimi i saj e deri me 31 Dhjetor 2004 ne masen ***33 312 177 leke***
Kapitali Nenshkruar i shoqerise "HODAJ"Sh.p.k. Vlore mbas zmadhimit eshte ***33 512 177 leke*** qe zoterohet nga personi privat Z. Ilir HODAJ ne kuotat 100 %, sipas tabeles se meposhtme:

| Nr Rend. | Ortaket | Vlera ne leke | Vlera ne % |
|---|---|---|---|
| 1 | Ilir HODAJ | 33,512,177 | 100.00% |
| | **Totali** | **33,512,177** | **100.00%** |

Tirane me, 09 Korrik 2005

*Auditore e Licencuar*

**Fatbardha SHTREPI**

Ekspert Kontabel e Autorizuar
FATBARDHA SHTREPI
TIRANE - ALBANIA

*Ky raport eshte i vlefshem vetem per zmadhimin e kapitalit te Shoqerise.*